



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Komuna e Prishtinës**  
**Pristina Obstina-Municipality of Pristina**  
**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**



Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "NTSH AR-DRITI" të datës 14.04.2026 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i tribunës Flamurtari" me nr. të prokurimit 616-26-258-5-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "NTSH AR-DRITI" të datës 01.09.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "14.04.2026 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i tribunës Flamurtari" me nr. të prokurimit 616-26-258-5-2-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

### Arsyetim

Operatori ekonomik "NTSH AR-DRITI" (tutje "parashtruesi") me datë 14.04.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i tribunës Flamurtari" me nr. të prokurimit 616-26-258-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit: "Gjate analizimit të kontratave të ofruara në aneksin 6, kemi gjetur si në vijim. Grupi OE në listen e projekteve ka ofruar kontratën:

1.Ndertimi i parkut afër objektit të komunes së Mitrovicës Veriore në rrugën Clirimi, nuk gjendet në listen e projekteve të paraqitura nga OE dhe raporti teknik i kësaj kontrate është i perkohshëm dhe nuk i përmbushë kërkesat nga AK. 2.Ndertimi i objektit të Qendres së Mjekësisë Familjare në Fushe Kosovë, nuk ka pranimit teknik të nënshkruar nga komisioni dhe OE nuk është lider i kësaj kontrate dhe Ne konsiderojmë se OE nuk i ka përmbushur këto pike dhe është i përgjegjshëm në përmbushje të kësaj kërkesë nga AK

3.Pika 1 në listen e projekteve: 'Renovimi i shkollave filllore të mesme të ulet në Fushe Kosovë dhe fshatra' ky projekt është në listen e projekteve por nuk është e paraqitura kontrata dhe vetëm një referencë- Ne konsiderojmë se OE nuk i ka përmbushur këto pike dhe është i përgjegjshëm në përmbushje të kësaj kërkesë nga AK

4.Sipas listës së Projekteve nga OE pika nr2 'Renovimi i rrethojave të Shfmu Laura Skoti në fshatin Grabovc të poshtem dhe Shfmu Vellezrit Frasheri në Miradi e Eperme' –nuk e ka prezentuar kontratën vetëm një raport teknik - Ne konsiderojmë se OE nuk i ka përmbushur këto pike dhe është i përgjegjshëm në përmbushje të kësaj kërkesë nga AK . 5.Pika 3 në listen e projekteve:Renovimi i hapsirave të spitalit (lot 2 Renovimi i objekteve të administratës) -ky projekt është në listen e projekteve por nuk e ka paraqitur kontratën dhe vetëm një raport të pranimit teknik- Ne konsiderojmë se OE nuk i ka përmbushur këto pike dhe është i përgjegjshëm në përmbushje të kësaj kërkesë nga AK

6.Pika 4 në listen e projekteve:Rikonstruktimi i hapsirës publike në rrugën Egnatia Lagjia Ulpiana-ky projekt është në listen e projekteve por nuk e ka paraqitur kontratën dhe vetëm një certifikatë të pranimit të perkohshëm- Ne konsiderojmë se OE nuk i ka përmbushur këto pike dhe është i përgjegjshëm në përmbushje të kësaj kërkesë nga AK

Të gjitha projektet e paraqitura nga OE në listen e projekteve -Ne konsiderojmë se OE nuk i ka përmbushur dosjen e tenderit dhe është i përgjegjshëm në përmbushje të kësaj kërkesë nga AK-se –të gjitha projektet e paraqitura ku OE nuk është lider në asnjë projekt sipas kërkesës në FTD ku lideri është dashur të përmbushë së paku 60% të vlerës. 5. Operatori Ekonomik duhet të posedojë mjete, stabilitet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit. Pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës në Aneksin 7 të DT.

5. Një listë të pajisjeve, sipas Aneksin 7, Librezat e qarkullimit për automjetet që regjistrohen, Deklaratat unike doganore ose kontrata, fatura e blerjes për automjetet që nuk regjistrohen. Ne rastet kur OE ka marrëveshje për shfrytëzimin, OE duhet të dorëzojë edhe marrëveshjen për shfrytëzim të marrjes me qira.

1.Të kjo kërkesë kemi të gjetur se grupi OE DachGroup SHP.k & Papi.S Construction SH.P.K ka deshtuar në listen e pajisjeve të kerkuara :

Një ekskavator deri në 5.5t-ka prezentuar një marrëveshje huazimi me Albi trans 2023 L SH.P.K ku ka prezentuar faturën me nr 25-SHV01-001-5 dhe dudin doganor por nuk paraqitur dëshminë e pagesës bankare- Ne konsiderojmë se OE nuk i ka përmbushur këto pike dhe është i përgjegjshëm në përmbushje të kësaj kërkesë nga AK.

Një ekskavator deri në 5.5t-ka prezentuar një marrëveshje huazimi me Burimi E SH.P.K ku ka prezentuar faturën me nr 15/2022 nga MANI SH.P.K dhe fatura me nr 20/2024 nga FATMIR X BOSHNJAKU B.I dhe dudat doganor por nuk paraqitur dëshminë e pagesës bankare - Ne konsiderojmë se OE nuk i ka përmbushur këto pike dhe është i përgjegjshëm në përmbushje të kësaj kërkesë nga AK

Një ekskavator deri në 5.5t-ka prezentuar një marrëveshje huazimi me Varna SH.P.K ku ka prezentuar kontratën për shitblerjen dhe dudin doganor por nuk ka paraqitur faturën dhe dëshminë e pagesës bankare - Ne konsiderojmë se OE nuk i ka përmbushur këto pike dhe është i përgjegjshëm në përmbushje të kësaj kërkesë nga AK.

4. Operatori ekonomik duhet të dorëzojë katalogun nga prodhuesi me specifikat e kerkuara për pozicionet e paramasës (9,12,13)

5. Një listë të pajisjeve, sipas Aneksin 7, Librezat e qarkullimit per automjetet qe regjistrohen, Deklaratat unike doganore ose kontrata, fatura e blerjes për automjetet qe nuk regjistrohen. Ne rastet kur OE ka mareveshje per shfrytezimin, OE duhet te dorezoj edhe marreveshjen per shfrytezim te marrjes me qira. Te kjo kerkese kemi gjetur se Grupi OE DachGroup SHP.k & Papi.S Construction SH.P.K nuk i ka permbushë kriteret ne dosjen e tenderit. SIpas deshmive te paraqitura nga OE çertifikata nga DOQANLED nuk i ploteson kerkesat e paraqitura nga AK pasi qe ne konsidrojme ky dokument eshte jo valid dhe permbane shenime shume te pakta dhe jo konkrete.

Dhe ne autorizimin e EURO ON GROUP SH.P.K e paraqitur nuk jane te cekura ne autorizim pika 12 dhe 13. Ne konsiderojme se OE nuk i ka permbushur kete pike dhe eshte i pergjegjshem ne permbushje e kesaj kerkese nga AK. Pasi qe ne Ftd eshte kërkuar qe te jete qe te jete autorizimi valid per pozicionet e caktuara. Ndersa per autorizimin nga prodhuesi Yucel Bahce kekrojme qe te verifikoni nga prodhuesi nese ky autorizim eshte valid, pasi ka mundesi qe te behen manipulime ne menyre digjitale te nenshkrimit pasi ne autorizim nuk ka asnje informate mbi te dhenat e biznesit ku duhet te kete ndonje informate mbi kontaktin e autoridhenezit e qe ne kete rast mungojne dhe si te tille e konsiderojme te nevojshme dhe te obligueshme qe te behete verifikimi ne menyre qe te validitohet autorizimi perndryshe ky autorizim konsiderohet i pavlefshem”.

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit fillimisht duhet sqaruar se parashtruesi ka dorëzuar ofertë më të shtrenjtë sesa tenderuesi i rekomanduar për kontratë. Tutje, parashtruesi nuk ka marrë parasysh faktin që AK ka kërkuar sqarime shtesë nga tenderuesi i rekomanduar ashtu që janë eliminuar të gjitha dilemat eventuale të komisionit vlerësues dhe është konstatuar se tenderuesi i rekomanduar i ka përmbushur të gjitha kërkesat e DT si dhe ka dorëzuar ofertën më të lirë, rrjedhimisht është tenderuesi i përgjegjshëm me cmimin më të lirë për cka edhe është rekomanduar për dhënie të kontratës.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi. Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 17.04.2026

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës

#### Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.